

DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



PREZANTIMI I DHOMËS SË BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE ME RRJETIN NDËRKOMBËTAR TË BIZNESIT (BNI)

Me ftesë të anëtarit të Kryesisë të Dhomës së Biznesit të Diasporës, z. Panajot Rumi, Kryetari i Dhomës, z. Ardian Lekaj, anëtarja e Kryesisë, zj. Jorida Qirjako, dhe Drejtori Ekzekutiv, Z. D. Tabaku, morën pjesë në një takim virtual me organizatën BNI Connect Greece, ku prezantuan shkurtimisht Dhomën e Biznesit të Diasporës Shqiptare dhe u njohën nga afër me anëtarë dhe drejtues të kësaj organizate. Organizatorët e takimit bënë një prezantim të shkurtër të anëtarëve të BNI Connect Greece, përfshirë këtu biznese nga Greqia, Italia, Britania e Madhe, Australia, etj., dhe propozuan mundësi bashkëpunimi në fushën e turizmit dhe fusha të tjera si ndërtimi, konsulencë, etj.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



DHOMA E BIZNESIT E DIASPORËS SHQIPTARE MIRËPRET ANËTARIN MË TË RI - DAMEN SHIPYARDS

DAMEN është një biznes i krijuar nga familja e njohur holandeze Damen në vitin 1927 në Holandë. Ndonëse selia dhe zemra e kompanisë mbeten ende në shtetin amë, nën udhëheqjen e drejtuesit të saj Z. Kommer Damen, grupi u zgjerua në arenën ndërkombëtare dhe aktualisht ka në administrim dhe pronësi 34 kantiere detare në të pesë kontinentet. Damen Shipyards nuk është i panjohur për Shqipërinë. Z. Frank de Lange, Drejtor i Departamentit për Evropën, e njeh mjaft mirë vendin tonë dhe ka një ndjenjë të veçantë për Shqipërinë. Nën drejtimin e tij, në vitin 2009, Damen Civil nisi aktivitetin për projektimin dhe ndërtimin e një qendre të re riparimi të anijeve si dhe në modernizimin e/platformave të vjetëruara të daljes në det në vendin tonë.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



NGA ARDIAN LEKAJ / 2021,NJË VIT SHPRESËPLOTË!

Situata e sotme ka një influencë të jashtëzakonshme në identitetin tonë si individë. Kjo pandemi na ka detyruar të mendojmë më thellë për çdo gjë që ndodh rreth nesh. Është fare e qartë se në momente krizash ndodhin ndryshime dhe është më e thjeshtë të pranohen nga njerëzimi. Le të marrim si shembull digjitalizimin. Patjetër që të gjithë e kishim të qartë se sa i rëndësishëm ishte digjitalizimi, por nga situata e krijuar u detyruam ta përshpejtojmë këtë proces. Platoni kishte të drejtë kur thoshte “nevoja është mamaja e inovacionit”. Periudha që ne po jetojmë sot është një nga periudhat më interesante të njerëzimit. Transformohu, ndrysho, mbijeto apo zhduku. Kur ke një ide, je në rregull, kur nuk ke, je i pavlerë.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



JAVA NË LAJME

GREQI/ “BIZNESI NUK NJEH KUFIJ” KONFERENCË PËR SIPËRMARRËSIT SHQIPTARË



“CONNECT ALBANIA”, NJË PROJEKT QË DO TË ZBULOJË ENERGJI TË REJA NË DIASPORË



BIZNESMENI LAZIM DESTANI MUNDËSON BOTIMIN E LIBRIT “DEMOGRAFIA E KOSOVËS”



KURSI I KËMBIMIT

MONEDHA	BLERJE	SHITJE
USD	101.5	102.5
EUR	123.3	123.9
CHF	114	115
GBP	138.4	139.3
DKK	16 ^{.25}	16.65